

## **NESHKRIMI I MARRVESHJES SE BASHKEPUNIMI ME AZHBR ( pë që ) DHE LEKSION I HAPUR ME STUDENTET**



Ditën e hënë, datë 30 Janar 2023, në mjediset e Kolegjit Universitar "LOGOS", u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me AZHBR (Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural). Më pas drejtoresha e kësaj agjencie, zj. Eranda Selmanaj, mbajti një leksion të hapur për studentët.

Tema e leksionit të hapur ishte "Të rinjtë në bujqësi". Ndër të tjera në këtë leksion u theksua rëndësia e të rinjve në bujqësi si dhe kriteret për përfitimin e granteve për të rinjtë.

Leksioni i hapur pati mjaft interes nga audienca e përbërë nga studentë dhe pedagogë të cilët morën pjesë me pyetjet dhe diskutimet e tyre.

Zj. Semanaj foli mbi modelet e suksesit në skemat kombëtare ku janë kryer pagesa për shumë fermerë në një sërë skemash mbështetëse. Ajo shpjegoi mënyrën se si përfitohen këto pagesa, kohën e hapjes së aplikimeve për këtë vit dhe mënyrën se si zhvillohet informimi mbi skemat kombëtare mbështetëse. U sqaruan gjithashtu

kriteret konkurruese me pikë për vlerësimin e aplikantëve. Ajo foli gjithashtu dhe mbi programin “Tirana Youth Capital” dhe bashkëpunimet me universitete të ndryshme për pjesëmarrjen e të rinjve.

E pyetur nga audienca, zj. Semanaj foli dhe mbi sfidat e AZHBR, kryesisht në drejtim të thithjes së fondeve dhe sigurimin që fondet mos të digjen përmes udhëzimit të sipërmarrësve për t’i plotësuar kriteret në kohën e duhur. Ajo gjithashtu theksoi sfidën e dixhitalizimit i cili përfshin përpjekjet për aplikimet online me e-albania.

Më shumë informacion të rinjtë mund të marrin në website-in e AZHBR dhe në rrjetet sociale: [azhbr.gov.al](http://azhbr.gov.al). Në rrjetet sociale ata mund të gjejnë raste suksesti të sipërmarrësve të rinj në sektorin bujqësor.

Në fund të takimit, zj. Selmanaj ofroi mundësinë për bashkëpunime të mundshme në përfshirjen e studentëve dhe pedagogëve në fushatat e informimit që AZHBR do të bëjë tek fermerët në qarqet e gjithë Shqipërisë.

Koleji Universitar “LOGOS” – Dritë dhe fuqi jete!















[Kolejji Universitar Logos](#)